

1 E enjte, 14 dhjetor 2023

2 [Konferencë për Ecurinë e Gjendjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 11.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve, ju
7 që jeni në sallën e gjyqit dhe ju që na ndiqni nga larg.

8 Z. Sekretar i seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2023-10, Prokurori i
11 Specializuar kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit.
12 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Tani i kërkoj palëve që të prezantohen duke filluar nga
15 Zyra e Prokurorit të Specializuar.

16 Znj. Prokurore, fjala për ju.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
18 Gjykatës. Prokurori i Specializuar është i përfaqësuar sot nga
19 znj. Taz Shahabuddin, Prokurore; Julie Mann, menaxhere rasti;
20 Maria-Cristina Manolescu, stazhiere ligjore, dhe unë Silvia
21 D'Ascoli, Prokurore.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Tani u lutem Mbrojtjeve që të prezantohen.

24 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit. Unë jam bashkëmbrojtësi
25 dhe përfaqësuesi i Mbrojtjes për z. Halilaj [Sipas

1 përkthimit].

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

3 Z. SYTEMA: [Përkthim] Unë jam përfaqësuesi i z. Bahtjari.

4 Z. REES: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë që harrova të
5 përmend dy anëtarë të tjerë të ekipit të Mbrojtjes. Kam dy
6 anëtarë së bashku në ekipin e Mbrojtjes, përfshirë këtu edhe
7 z. Daniel Bowden.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. E morëm shënim
9 për procesverbal.

10 Tani z. Nilsson.

11 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Jonas
12 Nilsson, jam nga Zyra Administrative.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për procesverbal, jam
14 Nicolas Guillou, dhe jam Gjykatësi i Procesit Parapërgatitor
15 për këtë çështje.

16 Me datën 8 dhjetor, unë planifikova Konferencën e tretë
17 për Ecurinë e Çështjes për këtë çështje gjyqësore. Qëllimi i
18 ditës së sotme është që të rishikoj gjendjen e çështjes dhe të
19 organizojmë më tepër shkëmbimet ndërmjet palëve.

20 Në veçanti, së pari do të diskutojmë për nxjerrjen e
21 materialeve, gjendjen e hetimeve të ZPS-së, pikat për të cilat
22 palët bien dakord dhe statusin e hetimeve të Mbrojtjes,
23 çështje të cilat kanë të bëjnë me kërkesën e Prokurorisë,
24 transmetimin e parashikuar të çështjes gjyqësore në përputhje
25 me rregullën 71(1) dhe kohës kur palët janë gati për gjykim,

1 çështje të cilat kanë të bëjnë me IT-në që ngrihen nga
2 Mbrojtja e z. Januzi që kanë të bëjnë me përgatitjen e z.
3 Januzi, dhe së fundi çështja apo pika të tjera për të cilat
4 palët duan të diskutojnë.

5 Së pari më lejoni që t'i falënderoj palët për
6 parashtrimet me shkrim të dorëzuar përpara Konferencës për
7 Ecurinë e Çështjes. Si zakonisht dëshiroj që t'ju kërkoj
8 palëve dhe Zyrës Administrative që t'i japin pikëpamjet e tyre
9 në mënyrë koncize për secilën nga pikat në rendin e ditës sot.

10 I kujtoj palëve dhe Zyrës Administrative që të na
11 njoftojnë paraprakisht në qoftë se parashtrimet e tyre do të
12 çojnë në nxjerrjen e informacionit konfidencial në mënyrë të
13 tillë që të mund të kalojmë në seancë private.

14 Le t'i marrim pikat njëra pas tjetrës. Pika e parë në
15 rendin e ditës është nxjerrja e materialeve. Së pari, dëshiroj
16 që t'i kërkoj Prokurorisë që të na informojë lidhur me
17 progresin e bërë për nxjerrjen e materialit shkresor. Kam
18 marrë parasysh parashtrimin e ZPS-së sa i takon çështjes së
19 nxjerrjes së materialeve. Vërej veçanërisht që Prokuroria
20 tregon që do të përfundojë detyrimet që rrjedhin nga rregulla
21 102(1) (b) më 15 dhjetor 2023.

22 ZPS-ja specifikon që nxjerrjet e materialeve sipas
23 rregullit 102(1) (b) po përgatiten në përputhje me kërkesën
24 F00108 dhe që do të kërkojë autorizim në Gjykatë për të vijuar
25 më tej sipas parashikimeve që do të përcaktohen në vendim.

1 Vërej që vendimi F00131, ku kam miratuar kërkesën F00108,
2 është nxjerrë dje. Kështu që si rezultat ZPS-ja mund të
3 vazhdojë me nxjerrjen e materialeve sipas rregullit 102(1)(b)
4 në përputhje me atë çfarë përcaktohet në vendimin tim.

5 Znj. Prokurore, dëshiroj t'ju pyes në qoftë se keni
6 ndonjë gjë për të shtuar, ndonjë parashtrim me shkrim për
7 çështjen e nxjerrjes së materialeve. Dhe gjithashtu, ju lutem,
8 të keni parasysh që sa i takon materialit të përbashkët kjo
9 është një çështje që do të trajtohet pak më vonë sot në
10 Konferencën për Ecurinë e Çështjes

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
12 Gjykatës.

13 Komentet tuaja u mbajtën shënim. Ne kemi mbajtur shënim
14 dhe kemi marrë parasysh gjithashtu edhe çështjet e përcaktuara
15 në vendimin tuaj. Nuk ka problem lidhur me këtë. Nuk kemi
16 asgjë shtesë. Megjithatë, mund t'i përgjigjem disa prej
17 elementëve dhe çështjeve që janë ngritur nga Mbrojtja e z.
18 Januzi për arsyen që duam që të jemi sa më qartë dhe të plotë
19 që të jetë e mundur.

20 Kemi mbajtur shënim shqetësimin e Mbrojtjes së z. Januzi
21 që ka të bëjë me vështirësitë për sa i takon dosjeve
22 elektronike që janë dhënë me datë 6 dhjetor. Kjo përcaktohet
23 në paragrafin 2 të parashtrimit. E kemi diskutuar këtë çështje
24 shkurtimisht përpara sesa të fillonte procesi sot. Duhet të
25 jetë e mundur për ne që të vlerësojmë përmbajtjen dhe

1 gjithashtu të bëjmë -- të japim ndihmën tonë në mënyrë të
2 tillë që të mos ketë vështirësi. Por, sigurisht jemi të lumtur
3 që të ndihmojmë më tej në qoftë se kolegët do ta kenë të
4 vështirë të punojnë.

5 Po ashtu dëshiroj që të shtoj një numër të kërkesave që
6 janë dorëzuar nga Mbrojtja e z. Januzi dhe e kam fjalën këtu
7 për paragrafët 3, 7, 2 dhe 12 të parashtrimit që do të
8 përfshijë materialin që do të nxirret sipas rregullit 102(1).

9 Në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër me të cilën mund t'ju
10 ndihmoj, jemi të lumtur që të ndihmojmë palët.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Tani do t'i jap fjalën Mbrojtjeve në mënyrë të tillë që
13 të ngrenë problemet që mund të kenë për klientët e tyre.

14 Z. Rees.

15 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne kemi
16 parashtrime që kanë të bëjnë me Konferencën për Ecurinë e
17 Çështjes të ditës së sotme. Dhe nuk dua që t'i kaloj këto
18 çështje njëra pas tjetrës se jam i sigurt që i keni lexuar
19 shqetësimet tona në parashtrimet e dorëzuara. Në veçanti do ju
20 kërkoja, i nderuar Gjykatës, që të jepni udhëzime që
21 Prokuroria të përgjigjet sa më shpejt që të jetë e mundur.

22 E di që ekziston një kuadër sa i takon nxjerrjes së
23 informacionit, megjithatë neve nuk na -- pra, ne mendojmë që
24 sa më shpejt të mund të nxirret materiali, aq më mirë do të
25 jetë. Kuadri ose vendimi që keni nxjerrë ju, i nderuar

1 Gjykatës, jep kuadrin limit kohor, kornizën kohore limite dhe
2 kjo jo domosdoshmërisht çon në nxjerrjen më të shpejtë të
3 mundshme të paketave me informacion.

4 Mendoj që të gjitha palët duhet që të kenë mundësi që të
5 ecin sa më shpejt që të jetë e mundur gjatë procesit, në
6 mënyrë të tillë që të bëhemi gati për gjykimin.

7 Lidhur me *hard drive*-in që kemi diskutuar, mbështetur në
8 rregullin 102(1)(b) që ka të bëjë me tre imazhe forenzike nga
9 telefona, më është thënë që mund të ketë softuer të cilët janë
10 pjesë e *hard drive*-it që mund ta ndihmojnë Mbrojtjen për të
11 parë këtë material.

12 Anëtarë të tjerë të ekipit tim jemi përpjekur që ta
13 shikojmë këtë informacion. Nuk kemi qenë -- nuk kemi pasur
14 mundësi ta bëjmë një gjë të tillë. Megjithatë, neve jemi
15 paralajmëruar që kur *hard drive*-i është dorëzuar, hetuesi i
16 cili nuk mendoi që do të kishte material në të dhe që do të
17 duhej që të përdorej ndihma e ekspertëve për sa i takon
18 marrjes së këtij materiali. Dua t'i drejtohem edhe një herë
19 znj. D'Ascoli dhe shpresojmë që këtë problem të mund ta
20 zgjidhim sa më shpejt që të jetë e mundur, pra në mënyrë të
21 tillë që të mund të shohim materialen që gjenden në këto
22 aparatura.

23 Ka disa çështje të tjera të cilat janë nxjerrë në
24 materialet, ndërkohë ju, i nderuar Gjykatës, keni një
25 përmbledhje të këtyre elementeve.

1 Edhe kjo jepet më konkretisht në paragrafin 4 të
2 parashtrimeve tona. Kjo ka të bëjë me kërkesën për të dhënat
3 për historikun e të dhënave për një dëshmitar. I nderuar
4 Gjykatës, besoj që ju kujtohet që unë e kam ngritur këtë
5 çështje herën e parë që kam ardhur këtu në këtë proces
6 gjyqësor, domethënë në Konferencën e dytë për Ecurinë e
7 Çështjes dhe ju, i nderuar Gjykatës, i kërkuat Prokurorisë që
8 të merreshin hapat e përshtatshëm për të siguruar këto prova.

9 Deri tani nuk është marrë asnjë hap. Kështu që do ju
10 kërkoja, i nderuar Gjykatës, që të përsërisnit, madje edhe më
11 me forcë dhe në mënyrë më vendimtare kërkesën që i keni bërë
12 Prokurorisë në Konferencën e dytë për Ecurinë e Çështjes. Ky
13 material është marrë dhe është specifikuar duke iu referuar
14 një kërkesë për të dhëna për thirrjet në marrëdhënie me
15 individë të tjerë. Pra, nuk ka ankesë në kërkesën tonë që
16 kërkesa jonë nuk është mjaftueshëm konkrete.

17 Çështja duhet të trajtohet me urgjencë.

18 Sa i takon nxjerrjes së informacionit besoj që kjo mund
19 të presë që së pari të marrë ZPS-ja materialet, dhe së dyti që
20 të shikojë edhe një herë vetë atë. Dhe në fakt ky ishte
21 qëndrimi që ju bëtë me dije në Konferencë e dytë për Ecurinë e
22 Çështjes, duke ngritur pra, faktin që së pari duhet që të
23 merret dhe të sigurohet ose këto informacione përpara sesa ato
24 t'i nxirren palëve.

25 Më pas në paragrafin 5 të parashtrimeve me shkrim jepet

1 një përmbledhje e një kërkesë ose kërkesave të tjera që janë
2 bërë, në fakt me datën 5 nëntor, në trajtën e korrespondencës
3 ndërmjet palëve ose *inter partes*. Këtu jepet një listë e
4 materialeve nga 5(a) në pikën (g), domethënë nga 5(a) deri në
5 5(g).

6 Duke marrë parasysh vendimin që keni dhënë dje, i nderuar
7 Gjykatës, mendoj që do të marrim një pjesë e këtij materiali,
8 besoj ose parashikoj nesër, në përputhje me parashikimet që
9 jepen në rregullën 102(1)(b). Megjithatë, ka edhe kërkesa të
10 tjera të cilat janë përfshirë në të për të cilat ne nuk është
11 se kemi marrë përgjigje të drejtpërdrejta, pavarësisht që na
12 është thënë me datë 6 nëntor që ne do të marrim një përgjigje
13 të plotë lidhur me këto kërkesa sa më shpejt që të jetë e
14 mundur.

15 Në paragrafin 7, ka kërkesa. Domethënë është paragrafi
16 7(ii) dhe parashikoj që kjo kërkesë duhet të përmbushet dhe
17 është trajtuar, në fakt, në kuadrin e parashtrimit të vendimi
18 që ju keni dhënë dje, i nderuar Gjykatës. Megjithatë, sa i
19 takon kërkesës sipas paragrafit 7(i) ne nuk e kuptojmë ose nuk
20 mendojmë që ka arsye se pse ka vonesa për dhënien e
21 informacionit të drejtpërdrejtë përderisa bëhet fjalë për një
22 çështje të drejtpërdrejtë për një informacion që është, kështu
23 që nuk e kuptojmë se pse ka vështirësi apo pse ka vonesa
24 lidhur me këtë.

25 Në paragrafin 9, ne i jemi drejtuar çështjeve që kanë të

1 bëjnë me elementë të rëndësishëm për ne. Jam i vetëdijshëm për
2 faktin që sa i takon njërës prej këtyre çështje, Mbrojtja
3 synon që t'i kundërpërgjigjet përgjigjes tonë nesër. Do ta
4 bëjmë këtë gjë pra, do të japim kundërpërgjigjen tonë lidhur
5 me këtë, megjithatë do të presim vendimin tuaj, i nderuar
6 Gjykatës, dhe do të shikojmë se cilat janë efektet pasuese që
7 do të rrjedhin si rezultat i vendimmarrjes tuaj.

8 Çështje që kanë të bëjnë me nxjerrjen e propozuar, pra me
9 kërkesën e përbashkët që ka të bëjë me nxjerrjen e materialeve
10 për një fazë më të vonshme të kësaj seance. Megjithatë, së
11 pari do të doja t'ju kërkoja që të ndihmoni me udhëzime për të
12 marrë përgjigje me shkrim për kërkesat që ne kemi bërë deri
13 tani në kuadrin shkëmbimeve *inter partes*.

14 Sa i takon Mbrojtjes, të paktën deri në këtë fazë, ne e
15 kuptojmë që nuk është bërë shumë progres lidhur me nxjerrjen e
16 materialeve që nga Konferenca e fundit për Ecurinë e Çështjes.

17 Na është thënë që do të bëhet një volum i konsiderueshëm
18 nxjerrje informacioni nesër. Por, ndërkohë do të duhet që ta
19 shohim informacionin nesër për ta ditur se për çfarë volumi
20 materialesh bëhet fjalë. Megjithatë, në këtë fazë do të donim
21 t'ju kërkonim që të na jepnit ndihmën tuaj sa i takon
22 nxjerrjes së materialeve dhe sa i takon elementeve të tjerë që
23 mund të na ndihmojnë ne për bërjen e punës tonë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. Sytema, fjala për juve.

1 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

2 Më duhet që t'i drejtohem parashtrimeve të mia *ex parte*
3 më herët kësaj jave ku kam thënë që diskutimet do të jenë
4 shumë të kufizuara për mua për momentin. Shpresoj që ta
5 kuptoni këtë.

6 Ndërkohë, mbaj shënim punën e mirë të ekipit të zgjeruar
7 të z. Januzi dhe do të ndjek hapat e tyre. Megjithatë, sikurse
8 e thashë edhe më herët, kontributi im do të jetë i kufizuar,
9 jo vetëm për këtë temë por edhe për tema të tjera që do të
10 diskutoni gjatë kësaj Konference për Ecurinë e Çështjes.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

12 Lidhur me pikën që ngritët ju, unë nuk shikoj ndonjë
13 arsye se pse duhet që të jenë të kufizuara ndërhyrjet tuaja
14 sepse ju jeni avokat kujdestar, i caktuar, kështu që nuk ka
15 kufizime të ndërhyrjes tuaj. Duhet ta bëni punën si zakonisht.
16 E kuptoj qëndrimin tuaj, megjithatë, sa i takon kësaj Gjykate,
17 ju jeni Avokati ose Mbrojtja e z. Bahtjari, kështu që duhet të
18 ushtroni tërësinë e funksioneve si Avokat i z. Bahtjari deri
19 në momentin kur të merret një vendim tjetër.

20 Nuk ka asnjë Mbrojtje që nuk plotësisht efektive edhe
21 besoj që kjo është një çështje e cila do të duhet të sqarohet,
22 në qoftë se, për shembull, nuk ka qenë mjaftueshmërisht e
23 qartë kjo në sistemin *Legal Framework* doja që ta theksoja edhe
24 një herë që ju duhet të merrni përsipër të gjitha funksionet e
25 avokatit.

1 Përpara sesa të kalojmë me pikën tjetër dua që t'i pyes
2 Prokurorët, ta pyes Prokuroren dhe Zyrën Administrative në
3 qoftë se kanë ndonjë vështirësi Mbrojtja e z. Januzi për
4 përdorimin e softuerit misterioz me *hard drive*-in. Nuk e di
5 sesi funksionon kjo në praktikë. Dua t'i kërkoj Zyrës
6 Administrative të thotë në qoftë se është në gjendje që të
7 japë këshilla IT-je për sa i takon ekipeve të Mbrojtjes së të
8 akuzuarve.

9 Z. NILSSON: [Përkthim] Zyra Administrative gjithmonë
10 përpigjet që të ndihmojë sa më shumë të jetë e mundur.
11 Sigurisht që ne nuk është se dimë më tepër për sa i takon
12 softuerit apo çfarë problemi ka ai, megjithatë, në qoftë se
13 është e nevojshme dhe në qoftë se na kërkohet ndihma jemi të
14 gatshëm që të ofrojmë ndihmën tonë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

16 Kjo do të thotë që në qoftë se z. Rees, për shembull, nuk
17 ka mundësi që të ketë qasje në informacionin në aparat,
18 pavarësisht aftësive të tij në informacion dhe teknologji dhe
19 në qoftë se keni nevojë për udhëzime të tjera, unë do t'i
20 ftoja palët që të kontaktonin me Zyrën Administrative në
21 mënyrë të tillë që një person nga sektori ose departamenti i
22 informacionit dhe teknologjisë mund t'i ndihmonte ata sesi
23 mund të kenë qasje në informacion.

24 Tani le t'i jap fjalën Prokurorisë

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

1 Së pari, dua që të filloj t'i jap përgjigje kërkesës së
2 Mbrojtjes që ka të bëjë me kundërpërgjigjen e korrespondencës
3 që mban datën 5 nëntor. Besoj që është e qartë për Mbrojtjen
4 nga përmbajtjet e kërkesave të tjera dhe dokumenteve të tjera
5 të paraqitura nga Prokuroria që kërkesa për masa mbrojtëse,
6 sipas rregullit 102(1)(b) që është parashtrim i protokolluar
7 F00108 pra, besoj që është e qartë përmes asaj çfarë kemi
8 dërguar me postë elektronike për palët se cilat janë arsyet se
9 pse nuk e kemi nxjerrë informacionin dhe pse informacioni do
10 të nxirret për palët nesër.

11 Ka dy pika që dua të ngre që kanë të bëjnë me komunikimin
12 ndërmjet palëve. Ne kemi komunikuar gjithashtu përmes postës
13 elektronike të datës 13 dhjetor dhe kemi thënë që fakti është
14 që ne nuk zotërojmë kopje të regjistruara me video dhe audio
15 sipas specifikimeve që kërkohen në kërkesën e Mbrojtjes, dhe
16 që çdo gjë që ne kemi në zotërim e di edhe Mbrojtja. Dhe
17 sigurisht që ne dokumentin që nuk ja kemi dhënë Mbrojtjes deri
18 tani do t'ja japim nesër në paketën e nxjerrë të informacionit
19 që e ka afatin nesër.

20 Sa i takon të dhënave të thirrjeve për dëshmitarin 0001,
21 informacioni i shkëmbyer përmes komunikimeve *inter partes*.
22 ZPS-ja e ka informuar Mbrojtjen që po e shqyrton kërkesën dhe
23 se nuk ka detyrim që të kryerje hetim në emër të Mbrojtjes.
24 Megjithatë, pas marrjes së arsyeve ne po shqyrtojmë mundësinë
25 e hetimit.

1 Pra, këtë kam për të thënë lidhur me atë çfarë ne e
2 quajmë historikun e të dhënave të thirrjeve. Megjithatë, siç e
3 dini, i nderuar Gjykatës, ne kemi ndërmarrë hapa për të
4 siguruar telefonin celular të dëshmitarit 0001 dhe hollësi të
5 tjera, pra jepen në Shtojcën 2, që është parashtrimi i ZPS-së
6 për këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjes që është
7 parashtrimi i protokolluar F000126. Besoj që kaq kisha për të
8 thënë lidhur me këtë pikë.

9 Ka një tjetër pikë në kërkesë, përsëri kjo ngrihet në
10 paragrafin 5, ku kërkohen kopje të regjistrimeve në audio dhe
11 video të intervistave të dëshmitarëve të cilat neve do t'i
12 nxjerrim përmes transkripteve nesër.

13 As nuk kërkohet ligjërisht dhe as nuk është praktika e
14 ZPS-së që t'i japë intervistë në video dhe në audio të ZPS-së
15 dhe kjo ndodh për disa arsye, për shembull, për shkaqe
16 logjistike ose për punën e madhe që duhet apo redaktimet e
17 nevojshme që mund t'ju bëhen transkripteve ose versioneve të
18 regjistruara në audio dhe video.

19 Megjithatë, Mbrojtja do të marrë transkriptin e
20 intervistës që përmenden në paragrafin 5(a) dhe (b) të
21 parashtrimeve të tyre. Pra, brenda afatit kohor. Dhe afati
22 kohor, siç e dimë është data 15 dhjetor. Sa i takon
23 fushëveprimit të kërkesave, sa i takon redaktimeve të
24 kufizuara që kanë të bëjnë me aplikimin e redaktimeve në këto
25 intervista, ZPS-ja është e gatshme që të bëjë një përjashtim

1 në praktikën e vet duke dhënë videot e transkripteve të veta,
2 megjithatë, dëshiroj që të them që kjo është diçka që nuk mund
3 të realizohet për nesër. Por, shpresojmë që të jemi në gjendje
4 që ta japim këtë informacion sa më shpejt që të jetë e mundur,
5 diku nga fillimi i 2024.

6 Lidhur me kërkesën e Mbrojtjes në paragrafin 5(g) dhe 7,
7 më lejoni të them që ka pasur shumë informacion sipas
8 materialit 103, që është dorëzuar me 16 nëntor, që do të
9 dorëzohet me 16 nëntor. Sa i takon kërkesës së Mbrojtjes për
10 konfirmimin që z. Januzi nuk ka rekorde penale, ZPS-ja nuk
11 është në pozicion që ta konfirmojnë këtë dokument, megjithatë
12 ne kemi përpunuar një raport që ka të bëjë me këtë çështje. Ky
13 do të jetë pjesë e paketës sipas rregullës 102(3), megjithatë
14 jemi të gatshëm që këtë informacion t'ia bëjmë me dije
15 Mbrojtjes edhe më herët sesa afati i planifikuar. Kështu që do
16 ta japim këtë informacion përpara afatit që parashikohet sipas
17 rregullës 102(1)(b).

18 Ky është fundi i komenteve të mia shtesë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

20 Prokurore.

21 Përpara sesa t'i jap fjalën Mbrojtjes dëshiroj të marr
22 disa siguri ose garanci lidhur me CDR-në, me diskun. A mund të
23 konfirmoni sot se ruajtja e provave dhe e provave të Mbrojtjes
24 për sa i takon CD-së, pra ku është regjistruar biseda,
25 sigurohet nga zyra juaj, çfarë do të thotë që Mbrojtja në

1 vetvete nuk duhet që të bëjë një kërkesë konkrete për këtë
2 aspekt?

3 Po jua bëj këtë pyetje sepse në qoftë se nuk jeni
4 tërësisht të sigurt, do i kërkoja Mbrojtjes që të bënte një
5 kërkesë me shkrim dhe të ma dorëzonte atë, në mënyrë të tillë
6 që të sigurohemi që nuk kemi zhdukje të provave, në veçanti
7 për këtë temë konkrete. Për këtë arsye po jua bëj këtë pyetje,
8 kështu që dua që të jepni një përgjigje znj. Prokurore

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, e
10 sigurt se e thashë dhe pak më herët, ne po e shqyrtojmë këtë
11 kërkesë. Do të mundohemi që të japim një përgjigje, por nuk të
12 jap dot një përgjigje fundore sot. Megjithatë, sa i takon
13 hapave proceduralë Mbrojtja është informuar për këtë. Në qoftë
14 se nuk e nxjerrim dot nesër, do të mundësohemi të japim një
15 përgjigje deri nga fillimi i javës që vjen. Megjithatë, një
16 përgjigje përfundimtare nuk ja u japim dot sot.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore, me çfarë
18 kuptoj nga parashtrimet tuaja nuk e thoni dot me siguri akoma
19 këtë gjë, pra, nuk angazhoheni plotësisht për këtë por thoni
20 që një përgjigje solide do t'i jepet Mbrojtjes nesër.

21 Në qoftë se zyra juaj do të vendosë që të mos vazhdojë më
22 tej me CDR-në, me diskun dhe materialin që ka kërkuar
23 Mbrojtja, do i kërkoj Mbrojtjes që të më dorëzojë një kërkesë
24 me shkrim në mënyrë të tillë që unë të marr një vendim lidhur
25 me këtë pikë.

1 A është e qartë kjo për palët?

2 Z. REES: [Përkthim] Është e qartë për neve

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është e qartë edhe për
4 Prokurorinë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po ashtu e ftoj Prokurorinë
6 që të shmangë debate juridike të panevojshme.

7 Tani dua që t'i jap fjalën Mbrojtjes që t'i përgjigjet
8 parashtrimeve të Prokurorisë.

9 Fjala për ju, z. Rees.

10 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit shumë për sqarimet e
11 dhënë nga znj. D'Ascoli për disa prej pikave të ngritura prej
12 nesh, në veçanti faktin që janë marrë hapa sa i takon
13 sekuestrimit të një telefoni që është një prej çështjeve që ne
14 kemi ngritur në Konferencën e dytë për Ecurinë e Çështjes.

15 Dua ta ngre edhe një herë që, në frymën e bashkëpunimit,
16 në mënyrë të tillë që të lejojmë çështjet që të ecin përpara,
17 sigurisht që e kuptojmë se ka raste kur Prokuroria kërkon ex
18 *partë* urdhra përpara Gjykatës. Asnjëherë nuk na është dukur,
19 gjithsesi, që kjo do të thotë që nuk mund të ketë komunikime
20 kur, për shembull, një çështje ngihet në korrespondencën *inter*
21 *partes* dhe që të na thonë ata, për shembull, që të përfshihet
22 ose diskutohet, për shembull, përmbajtja ose hollësitë
23 ndërmjet palëve. Por në momentin kur Prokuroria i drejtohet
24 Trupit Gjykues, Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

25 Do të ishte mirë që ne të informohemi, domethënë të

1 informohemi se cila është ecuria e çështjeve, në mënyrë të
2 tillë që të sigurohemi që çështjet ndiqen. Megjithatë, e
3 kuptoj që për Prokurorinë ka kohë, ka momente kur hollësitë
4 nuk mund të na bëhen me dije ne, megjithatë, komunikimi duhet
5 të jetë produktiv dhe ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe
6 për ne.

7 Po ashtu, ju jam shumë mirënjohës sa i takon udhëzimit që
8 keni dhënë lidhur me përgjigjen e ZPS-së.

9 Megjithatë, një tjetër element i rëndësishëm për ne është
10 që do të duhet që të presim nxjerrjen e materialeve në mënyrë
11 të tillë që të bëjmë komentet e nevojshme dhe të përshtatshme
12 më pas.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

14 Z. Sytema, keni ndonjë gjë për të thënë?

15 Z. SYTEMA: [Përkthim] Jo, faleminderit, nuk kam asgjë për
16 të thënë.

17 Znj. Prokurore, keni ndonjë gjë për të shtuar sa i takon
18 nxjerrjes së materialit

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës,
20 thjeshtë sa për të thënë që e kemi dhënë përgjigje për
21 mesazhin elektronik përmes postës elektronike të z. Rees dhe
22 do jap një përgjigje më thelbësore sa më shpejt që të jetë e
23 mundur.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
25 znj. Prokurore.

1 Tani të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës që ka
2 të bëjë me statusin e hetimeve të ZPS-së.

3 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja ka thënë që rishikimi
4 dhe analiza e aktiviteteve të kohëve të fundit hetimore ka
5 çuar në disa hapa të cilat mund të çojnë në zgjatjen e dhënies
6 së informacionit deri në janar 2024.

7 A mund të shtoni, doni të shtoni ndonjë gjë lidhur me
8 këtë pikë, znj. Prokurore?

9 Nuk e di z. Prokuror ose znj. Prokurore.

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo, faleminderit, i nderuar
11 Gjykatës. Ne kemi dhënë disa hollësi që parashikojmë që të
12 lidhim me disa hapa të tjera shtesë që parashikojmë që të
13 ndodhin në parashtrimet e *ex parte*. Megjithatë, në qoftë se ka
14 zhvillime të reja, sigurisht që do ta njoftojmë Trupin Gjykses
15 lidhur me këtë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
17 Prokurore.

18 Nuk e di tani dua t'i kthehem Mbrojtjes.

19 Z. Rees, keni ndonjë parashtrim për të bërë lidhur me
20 këtë pikë?

21 Z. REES: [Përkthim] Kam vetëm këtë për të thënë: Duke
22 marrë parasysh faktin që ju keni ngritur çështjen e
23 kalendarit, dua t'ju kërkoj në qoftë se mund t'ju ndihmojmë,
24 në mënyrë të kuptimtë për këtë pikë dhe për këtë arsye është e
25 rëndësishme që Prokuroria të ndajë me neve planin që ka.

1 Megjithatë, i takon Prokurorisë kjo gjë për ta bërë apo jo.

2 Megjithatë, dua të them që duke filluar nga Konferenca e
3 dytë për Ecurinë e Çështjes është që do kishte zhvillimeve sa
4 i takon hetimeve në Konferencën e tretë për Ecurinë e Çështjes
5 dhe në fakt tani dëgjojmë që në fakt nuk ka ndonjë zhvillim.

6 Megjithatë, ky pohim duket se është befasues, duke pasur
7 parasysh zhvillimet dhe atë çfarë ka ndodhur nga koha kur u
8 organizua Konferenca e dytë për Ecurinë e Çështjes deri tani
9 kur po organizohet Konferenca e tretë për Ecurinë e Çështjes.

10 Përsëri, sa i takon hetimeve të Prokurorisë lidhur me
11 nxjerrjen e materialeve ne na duket e parakohshme që të
12 trajtojmë elementin e kalendarit për fillimin e gjykimit,
13 ndërkohë që ne e dimë që hetimet e Prokurorisë vazhdojmë edhe
14 sot e kësaj dite dhe nuk kemi ndonjë informacion që sa kohë do
15 ju duhet atyre dhe sa kohë do të na duhet ne pastaj për të
16 bërë hetimet tona dhe për të vijuar më tej me çështjen.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Është e vërtetë që këto mund të kenë ndikim në kalendarin
19 e ardhshëm.

20 Z. Sytema, ju lutem.

21 Z. SYTEMA: [Përkthim] E vetmja gjë që mund të them është,
22 mbështes komentet e z. Rees lidhur me këtë. Ka shumë pasiguri
23 për ta ardhmen, pra nuk mund të bëj ndonjë koment serioz
24 lidhur me këtë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

1 Znj. Prokurore, dëshironi të shtoni diçka veçanërisht
2 lidhur me afatet kohore për hetimet tuaj.

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Pa hyrë në detaje, në
4 hollësi të mëtejshme, do theksoj vetëm që kemi identifikuar
5 hapa të kufizuar të nevojshëm të mëtejshëm. Besojmë që hetimi
6 është dinamik, gjërat mund të ndryshojnë, gjërat kanë
7 ndryshuar në të kaluarën. Megjithatë, mendojmë që në një
8 periudhë -- kemi nevojë për një periudhë të shkurtër kohore,
9 relativisht të shkurtër. Dhe kaq mund të them në këtë pikë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
11 Prokurore.

12 Për pikën e radhës në agjendë, i drejtohem Mbrojtjes
13 fillimisht.

14 Përpara se të them këtë, dua të nënvizoj që pres që ZPS-
15 ja dhe Avokatët Mbrojtës të ndërmarrin hapat e nevojshëm, nëse
16 është e nevojshëm, proaktiv, për të siguruar që lënda të
17 vijojë në mënyrë -- të shkojë në gjykim pra, në mënyrë të
18 shpejtë dhe pres që palët të bisedojnë në mirëbesim çështjet
19 që mund të dalin në lidhje me qasjen në prova për të gjetur
20 zgjidhje konkrete dhe marrëveshje të kënaqshme që të
21 përgatiten në kohë për të kaluar çështjen -- dosjen e lëndës
22 në gjykim.

23 Gjithashtu, ftoj palët që të më kontaktojnë kryetarin --
24 që të kontaktojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake në qoftë
25 se zgjidhjet dhe marrëveshjet e tjera nuk mund të arriten.

1 Tani, dua të dëgjoj parashtrimet e palëve, duke patur
2 parasysh informacionin që është dhënë nga ZPS-ja lidhur me --
3 gjatë Konferencës për Ecurinë e Çështjes, së pari, lidhur me
4 gjendjen e hetimeve; dhe së dyti, qëllimet e mundshme dhe
5 njoftimin e ndonjë alibie si dhe bazat, çdo bazë të mundshme
6 për përjashtimin e përgjegjësisë dhe nxjerrja e materiale; së
7 treti, qëllimi, çdo qëllim të mundshëm për të bërë kërkesa
8 lidhur me mundësitë hetimore të vetme; dhe së katërti, datat
9 që pritet për parashtrimin e dosjes paraprahe në gjykim.

10 Z. REES: [Përkthim] Në vendimin me shkrim, e keni bërë të
11 qartë nëse -- lidhur me parashtrimet, pra, që të siguronim
12 informacion për çështjet që ju i keni përmendur.

13 Ne, në përgjigjen tonë me shkrim, duke patur parasysh
14 pasiguritë, jo vetëm me nxjerrjen e materialeve, por edhe me
15 fushëveprimin pra, e lëndës thatë që duhet të merremi me këtë
16 çështje në momentin e bashkimit të mundshëm të lëndës. Dhe sot
17 nuk jemi në gjendje që t'ju ndihmojmë për atë që ju kërkon.

18 Ajo që ne presim është, ndoshta mund ta them kështu:
19 Shpresoj që do të jemi në gjendje ta bëjmë këtë në momentin e
20 Konferencën e katërt për Ecurinë e Çështjes. Kjo varet
21 natyrisht materiali që do të nxirren nesër dhe çështjet e
22 tjera që janë ngritur tani.

23 Mund të them që në parashtrimet tona me shkrim, nuk
24 mendoj që do të jemi në gjendje të parashtrojmë dosjen
25 paraprahe të premtën, me 1 mars. Do jemi të pranishëm. Por

1 duke patur parasysh që jemi akoma në një fazë të hershme të
2 nxjerrjes së materialeve duke pritur atë që do ndodhë nesër,
3 nuk mund të shoh që atë si datë e mundshme, reale.

4 Sa i përket kërkesës nëse ne synojmë që të bëjmë kërkesa
5 për mundësi hetimore unike, edhe këtu nuk mund të them, nuk
6 mund të shprehem, pra, në këtë fazë.

7 Përsërisim qëndrimin tuaj, pra, që palët duhet të punojnë
8 së bashku për të përgatitur në mënyrë sa më të shpejtë që
9 është e mundur për t'u përgatitur për gjykim, dhe që të
10 shkëmbejnë me Prokurorinë dhe ne do të veprojmë kështu, por
11 nuk jemi në gjendje sot që t'ju ndihmojmë më me hollësi lidhur
12 me çështjen -- në këto çështje, në këtë fazë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

14 Z. SYTEMA: [Përkthim] E njëjta gjë vlen për Mbrojtjen e
15 z. Bahtjari. Qëndrimi jonë varet shumë nga natyra e provave që
16 do të nxirren nesër, provat që do të nxirren si pasojë e
17 hapave hetimorë që janë në zhvillim e sipër. Gjithashtu, është
18 çështja e propozimit për të bashkuar lëndën, me lëndën 11 dhe
19 pas marrjes së këtyre informacioneve Mbrojtja e z. Bahtjari do
20 të jetë në gjendje të tregojë apo të pozicionohet për hapa të
21 mëtejshëm dhe hetime nga ana e Mbrojtjes. Pra, e njëjta gjë
22 vlen për z. Bahtjari. Faleminderit.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

24 Znj. Prokurore, dëshironi të bëni ndonjë parashtim
25 lidhur me këtë pikë?

1 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Asgjë si reagim ndaj atyre
2 që thanë kolegët e mi të Mbrojtjes, përveçse ne duhet të
3 vazhdojmë të shkëmbejmë në mënyrë proaktive me qëllim që
4 gjërat të ecin përpara dhe në veçanti lidhur me -- kjo do të
5 ndodhë nesër me nxjerrjen e materialeve.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
7 Prokurore.

8 Ftoj palët që të vazhdojnë të bashkëpunojnë në mënyrë
9 proaktive. Konferenca Statutore e radhës, siç u përmend nga
10 Mbrojtja do të jetë -- gjatë asaj do të jemi në gjendje që të
11 përfundojmë kalendarin, pra, për procedurës dhe kjo natyrisht
12 do të thotë që çështjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e
13 materialeve do të trajtohen në shkallën që palët që kanë
14 mundësi në konferencën e radhës.

15 Tani kalojmë te pika tjetër e agjendës.

16 Konstatoj që palët nuk kanë bërë ndonjë shkëmbim apo
17 diskutim lidhur me mundësinë për parashtrimin e pikave të
18 marrëveshjes mbi çështjet ligjore dhe faktike. Gjithashtu,
19 konstatoj që ZPS-ja synon të fillojë diskutime me Mbrojtjen
20 lidhur me -- pas kësaj Konference Statutore.

21 Dua të dëgjoj palët nëse bien në ujdi për kalendarin, në
22 qoftë se ka ndonjë. Gjithashtu dëshiroj t'ju rikujtoj se nuk
23 ka asnjë detyrim nga palët që të bien në ujdi në çështjet
24 ligjore dhe faktike përpara gjykimit.

25 Për më tepër, pikat e ligjit -- pikat ligjore dhe faktike

1 për të cilat është arritur një ujdi do të lihen për t'u
2 përcaktuar nga Trupi Gjykues.

3 Znj. Prokurore, keni diçka për të shtuar.

4 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Është qëllimi jonë, [E
5 pakuptueshme] që të angazhohemi me Mbrojtjen në afat të
6 shkurtër. Dhe besoj se në një shkallë afati kohor do të
7 drejtohet nga, do të përcaktohet nga kolegët e mi të Mbrojtjes
8 dhe shqyrtimi i tyre i provave, duke patur parasysh nxjerrjen
9 që do të bëhet si shtesë të materialeve që janë nxjerrë
10 tashmë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në qoftë se Mbrojtja është
12 në gjendje ta bëjë këtë gjë, do jeni ju që të përfshihen në
13 diskutime nga nesër deri në Konferencën e radhës për Ecurinë e
14 Lëndës.

15 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk presim që të kemi ndonjë
16 problem në shkëmbime me Mbrojtjen përpara konferencës së
17 radhës. Nuk jam në dijeni të ndonjë date akoma, por, besoj që
18 mund të fillojmë shumë shpejt shkëmbimet.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
20 Prokurore.

21 I kthehem Mbrojtjes tani.

22 Z. Rees.

23 Z. REES: [Përkthim] Më duket se çështja nëse mund të
24 pajtohem për pika -- çështje ligjore apo faktike është
25 çështje që do të vazhdojë të shqyrtohet gjatë të gjithë

1 procedurës. Natyrisht ne jemi të gatshëm të angazhohemi në
2 diskutime me Prokurorinë në çdo kohë që ata e kërkojnë. Dhe në
3 faza të ndryshme ne mund të kemi -- mund të arrijmë në pikën
4 ku të arrijmë marrëveshje në faza të mëvonshme dhe jo të
5 mëhershme, sepse kjo varet edhe nga mënyra sesi zhvillohen,
6 ecin përpara nxjerrja e materialeve apo mënyra sesi vendimet
7 që kërkohen nga Gjykata ndikojnë në qëndrimin tonë.

8 Pra, jemi shumë të gatshëm që të angazhohemi në shkëmbime
9 *inter partes* në çdo kohë kur kolegët e mi në anën tjetër na
10 kontaktojnë përmes telefonit apo emailit. Dhe ne gjithmonë
11 kërkojmë që të heqim sa më shumë punë nga Trupi Gjykses. Dhe
12 do ta vazhdojmë këtë, do ta bëjmë këtë gjë vazhdimisht në të
13 gjitha fazat e procedurës.

14 Ndërsa, ju, i nderuar Gjykatës, dëshironi të bëni një
15 kalendar për këtë që na jep afate kohore të caktuara, nëse
16 juve ja leni këtë Prokurorit dhe Avokatit Mbrojtës që të
17 aranzhojnë pra, në mënyrë që të Trupi Gjykses të ndihmohet
18 duke u përqendruar në çështje mbi të cilat duhet të
19 përqendrohet, u përket juve që ta vendosni. Ne do t'i
20 shqyrtojmë çështjet nëse kjo ndihmë mund të jetë e mundshme
21 apo jo për juve.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

23 Z. SYTEMA: [Përkthim] Pajtohem me parashtrimet e
24 parashtruara nga të dy palët, Prokuroria dhe z. Rees. Mbrojtja
25 e z. Bahtjari është në -- mbështet çdo trajtim praktik të

1 çështjes dhe është gati të bashkëpunojmë në çdo diskutim që
2 mund të çojë në zgjidhje praktike të çështjes.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

4 Kalojmë te pika e bashkimit të çështjes 10 dhe 11.

5 Konstatoj që siç është paralajmëruar nga ZPS-ja në

6 parashtrimet me shkrim, ZPS-ja ka bërë një kërkesë,

7 parashtruar kërkesë për bashkimin e lëndës 10 dhe 11,

8 konkretisht parashtrimi i protokolluar 132.

9 ZPS-ja ka cilësuar këtë kërkesë në lëndën -- në dosjen e
10 lëndës 11.

11 Afati kohor për Mbrojtjen e z. Januzi dhe z. Bahtjari për
12 t'ju përgjigjur kërkesës së ZPS-së për bashkimin e lëndëve bie
13 gjatë pushimit vjetor gjyqësor, që i bie me -- të hënën me
14 datën 18 dhjetor.

15 Për rrjedhojë, siç kam bërë në raste të mëparshme, synoj
16 që të ndryshoj këtë kalendar që t'ju jap kohë të mjaftueshme
17 Mbrojtjes për të përgatitur përgjigjet e tyre.

18 Përpara se të vazhdoj, i jap fjalën ZPS-së dhe Mbrojtjes
19 që të bëjnë parashtrimet e tyre lidhur me këtë pikë.

20 Pra, ju jap fjalën thjeshtë për çështjen e kalendarit për
21 përgjigjet e Mbrojtjes.

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk
23 kemi asnjë kundërshtim për sa i përket afateve kohore, duke
24 patur parasysh pushimin gjyqësor vjetor të ardhshëm.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

1 Prokurore.

2 Z. Rees.

3 Z. REES: [Përkthim] Jemi mirënjohës për marrjen parasysh
4 nga ana juaj z. Gjykatës, i pushimit vjetor dhe jemi
5 mirënjohës që ju bëni të qartë që -- jemi mirënjohës që ju
6 bëni të qartë që të na jepni më shumë kohë për t'u përgjigjur
7 kërkesës së Prokurorisë sipas rregullës 76.

8 Ka disa çështje që kanë të bëjnë me nxjerrjen e
9 materialeve që dëshiroj t'i ngre dhe e bëj të qartë që këto
10 çështje duhet të trajtohen përpara që kërkesa të trajtohet.
11 Nuk e kam fjalën në sensin negativ. Por, në shembullin e parë,
12 ne do të parashtrojmë një kërkesë të duhur për -- çdo kërkesë
13 e tillë për bashkim, duhet të shkojë bashkë me një draft-
14 propozim për aktakuzë të bashkuar. Kërkesa kërkon konsolidimin
15 e dy aktakuzave në një aktakuzë, pra. Ajo që propozohet si
16 aktakuzë e re duhet të jetë në kërkesë, duhet të jetë pjesë e
17 kërkesës.

18 Duhet të jetë të paktën si pjesë aneks e saj. Duhet të
19 jetë -- ky është parashtrim jonë, sipas rregullit të ri 86(3)
20 -- 86(3)(b), e cila vjen me aktakuzën e bashkuar të re të
21 propozuar pra, sepse edhe pse në kërkesë parashtrohet në terma
22 të përgjithshëm se aktakuzat janë të bazuara në të njëjta
23 akuza dhe fakte, ato janë -- ka dallime të qarta mes tyre
24 aktakuzave në rastin 10 dhe në aktakuzën e rastit tjetër -- në
25 çështjen numër 10, pra, dhe në aktakuzën apo të paktën për aq

1 mund të përcaktoj nga versioni -- duke u bazuar në versionin e
2 redaktuar publik, sepse nuk e kemi aktakuzën për çështjen 11,
3 edhe pse kërkesa është bërë për të bashkuar atë.

4 Ka një dallim të qartë mes tyre dhe ajo që është e
5 dukshme në versionin e redaktuar publik të aktakuzës në
6 çështjen 11. Mund të futem më në hollësi të këtyre, në qoftë
7 se dëshironi ta bëj këtë gjë, por mund të them se një lexim i
8 shpejtë, e bën atë të qartë. Pra, këto dallime mes dy
9 aktakuzave.

10 Pra, kërkesa në vetvete, përveç pohimit të përgjithshëm
11 nuk më duket që dy aktakuzat e propozuara duhet të jenë pjesë
12 e kërkesës, sepse duhet që një përkufizim -- parashtrim sipas
13 rregullës 86(3) (b) të jetë pjesë e saj.

14 Nuk mund t'i përgjigjem një kërkesë e cila parashtrohet
15 në terma të përgjithshëm pa parë se çfarë propozon Prokuroria
16 në fakt që të jetë aktakuza bashkuar dhe çfarë konkretisht ata
17 duan që kjo të jetë dhe një përcaktim që është i bazuar në
18 fakte.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, ju ftoj që t'i
20 paraqisni argumentet tuaja të gjitha parashtrimet tuaja me
21 shkrim. Po ju pyesja më shumë për kalendarin.

22 A jeni -- a ju përshtatet që të zgjasë kalendarin për
23 paraqitjen e tyre me një javë, deri në fund të pushimit?

24 Z. REES: [Përkthim] Do të kërkoj -- jam në rregull me
25 këtë, por do të kërkoja që të vijë bashkë me udhëzimin

1 përkatës dhe përpara se të arrijë në atë fazë Prokuroria të na
2 sigurojë ne aktakuzë -- draft-aktakuzën e bashkuar, rregulla -
3 - rregullës 86(3), rregulla që kërkon parashtrimin përpara
4 jush të provave mbi të cilat është bazuar aktakuza, e cila
5 është parashtruar për konfirmim në rastin 11. Këto çështje
6 duhet të na vihen në dispozicion së bashku me kërkesën. Dhe
7 pastaj në atë moment do të jemi në gjendje që të japim
8 përgjigjen tonë të duhur.

9 Pra, do t'ju kërkoj ju, z. Gjykatës, që të na zgjasni
10 afatet kohore për -- me qëllim që ne të parashtrojmë kërkesën,
11 të përgjigjes tonë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

13 Z. SYTEMA: [Përkthim] Edhe ju falënderoj për zgjatjen e
14 afatit kohor duke patur parasysh pushimet vjetore. Për pjesën
15 mbetëse, pajtohem komentet e z. Rees.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

17 Ja jap fjalën Prokurorisë tani, lidhur me aktakuzën e
18 konsoliduar si pas rregullës 86(3).

19 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

20 Do filloj duke thënë që kërkesa jonë lidhet ngushtë me
21 kriteret nga rregulla 81(1) -- 98 -- 89(1), dhe është
22 plotësisht e parashtruar në mënyrë të duhur. Qëndrimi jonë
23 është që ZPS-ja është bazuar në materialet e cituara në
24 kërkesë, përfshirë edhe versionet e redaktuara të dy
25 aktakuzave, dhe është e qartë që në këtë rasti bashkimi është

1 thjeshtë i logjikshëm dhe se këto dy raste janë natyrisht,
2 vijne së bashku.

3 Thënë këtë, ne parashohim që bashkimi që kërkohet nga
4 paraqitja e ZPS-ja për aktakuzë të bashkuar për t'u
5 konfirmuar, dhe që kjo do të shoqërohet nga parashtrimi sipas
6 rregullës 86(3) i materialeve për nxjerrje ndaj ekipeve
7 Mbrojtëse, në të dy rastet. Dhe me qëllim që gjërat të
8 lëvizin, dhe të avancojnë, me qëllim -- ne me gjithë qejf do
9 të vazhdojmë duke dhënë parashtruar, paraqitur aktakuzën e
10 propozuar të bashkuar për konfirmim.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kur mendoni të parashtroni
12 aktakuzën e konsoliduar dhe përmbledhjen e konsoliduar?

13 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Nuk ka përkthim]

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mund të konsultoheni me
15 kolegët për të dhënë një përgjigje.

16 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Nuk ka përkthim]

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Nuk ka përkthim]

18 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

19 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit. Ne propozojmë
20 që të na kërkohet të parashtrojmë materialet e propozuara nga
21 fundi i javës së parë, pas kthimit nga pushimi. Nuk e kam
22 datën në mendje, por di që i bie në janar, me datën 8. Pra, do
23 të kërkonim këtë afat kohor për t'u përgatitur.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

25 Prokurore.

1 Do të marr një vendim për kalendarin në fund të kësaj
2 Konferencë për Ecurinë e Lëndës.

3 Përpara se të kalojmë tek pika e radhës së agjendës, a
4 keni ndonjë vërejtje, diçka për të shtuar lidhur me kërkesën
5 tuaj për bashkim?

6 Znj. Prokurore.

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Meqenëse më jepet mundësia
8 do të nënvizojë disa gjëra që udhëheqin qasjen tonë lidhur me
9 kërkesën në rastin -- çështjen 11.

10 Së pari, kërkesa [Sipas përkthimit] ka bërë kërkesën për
11 bashkim sa më shpejt që ka patur mundësi duke bashkërenditur
12 lëndët sa më shpejt që është e mundur dhe se aranzhimet e
13 tjera shtesë mund të jenë të nevojshme në faza sa më hershme
14 të procedurës në të dy çështjet, edhe pastaj që të lëvizim --
15 çështja të ketë një ecuri të shpejtë, nëse ju, z. Gjykatës,
16 pranoni kërkesën tonë për bashkim.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i drejtohem Mbrojtjes.

18 Keni ndonjë parashtrim për të bërë lidhur me bashkimin.

19 Z. Rees.

20 Z. REES: [Përkthim] Shkurtimisht. Falënderoj zç -- ZPS-ja
21 do të parashtrorë kërkesën për -- që do të parashtrorë një
22 përmbledhje të konsoliduar që do të shoqërojë kërkesën e tyre
23 për bashkim.

24 Mendoj që fundi i javës 8 janarit është 13 janari, kështu
25 që do t'ju kërkoja z. Gjykatës që të na jepni afate kohore që

1 të përgjigjemi, mundësinë që të përgjigjemi pas datës 13
2 janar.

3 Rregulla të cilës po i referohesha është rregulla
4 102(1)(a), materiali mbi të cilin është konfirmuar aktakuza në
5 Çështjen 11. Dhe do të kërkoja që të na jepet nga fundi i
6 javës, që kjo të na sigurohet nga fundi i javës -- fundi i
7 javës që fillon me datën 8 janar, si pjesë e përgatitjes së
8 argumentit për bashkim.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.
10 Z. Sytema.

11 Z. SYTEMA: [Përkthim] Kalendari nuk do të jetë problem
12 për neve dhe nuk kam komente të tjera shtesë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.
14 Znj. Prokurore, keni diçka për të shtuar?

15 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po. Desha të shtoj thjeshtë
16 që dispozita e rregullës 86(3) që përfshin detyrimet tona
17 sipas rregullës 102(1)(a), ne do t'i sigurojmë ta dorëzojmë
18 atë në të njëjtën kohë kur të dorëzojmë aktakuzën e propozuar
19 për të bashkuar, si dhe përmbledhjen sipas rregullës 86(3).

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
21 Prokurore.

22 Kalojmë në pikën e radhës në agjendë. Do të doja që të
23 dëgjoj qëndrimin e palëve lidhur me kalimin e dosjes së lëndës
24 Trupit Gjykues në pajtim me rregullin 72 të rregullave, lidhur
25 me zhvillimin e shpejtë të procedurës.

1 Fillimisht konstatoj që ZPS-ja e ka thënë që nuk e
2 kundërshton kalimin e dosjes së lëndës Trupit Gjykues nga
3 data, me datë 15 mars 2024 dhe që do të jetë gati për gjykim
4 shkurt, në një kohë të shkurtër pas kësaj.

5 Mbrojtja e z. Januzi theksoi se nuk mund të parashikojë
6 një kalim të tillë të dosjes tek Trupi Gjykues përpara majit
7 2024, dhe gjykimi përpara korrikut 2024.

8 Qëndrimi i Prokurorisë lidhur me këtë.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk kemi diçka tjetër për të
10 shtuar përveç atyre që kemi thënë në parashtrimin e
11 protokolluar që synojmë që të bashkërendisim dy lëndët në një
12 kohë të shkurtër, dhe nuk parashohim ndonjë problem për datën
13 e përcaktuar nga juve, z. Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
15 Prokurore.

16 Z. Rees.

17 Z. REES: [Përkthim] E vetmja që do të shtoja është që
18 qëndrimi jonë i shprehur në paragrafin 16 të parashtrimit tonë
19 vetëm përforcohet nga diskutimet që sapo bëmë sot. Kemi një
20 sasi pune të madhe që Prokuroria po bën qoftë me hetimet e
21 tyre po edhe me çështjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e
22 materialeve.

23 Ne, siç e thamë, presim që nesër të nxirret një sasi e
24 konsiderueshme materialesh, por, është gjithashtu çështja e
25 telefonit që ata e kanë dhe për të cilin nuk kishin dijeni më

1 herët dhe kjo çështje që natyrisht është e rëndësishme për
2 përgatitjen e Mbrojtjes, mënyra sesi telefoni analizohet dhe
3 materialet e nxjerura lidhur me këtë.

4 Çështja që është akoma, mbetet për t'u trajtuar, lidhur
5 me të dhënat e thirrjeve telefonike, është akoma për t'u
6 trajtuar dhe ka pasiguri në lidhje me mënyrën se si do të
7 veprojmë lidhur me këtë.

8 Ne parashikojmë, siç e kemi thënë në paragrafin 16, ato
9 qëndrojmë pranë atyre parashikimeve, pra.

10 Natyrisht këto çështje do të trajtohen përsëri në
11 Konferencë për Ecurinë e Lëndës së ardhshme kur çështjet do të
12 jenë ndoshta -- këto pikat do të jenë më të qarta dhe
13 konstatoj -- vërej se ju, i nderuar Gjykatës, do të trajtoni
14 mundësinë për Konferencë për Ecurinë e Lëndës së ardhshme. Do
15 të thoja vetëm këtë se konferenca e ardhshme më duket se është
16 -- do jetë më produktive sepse do kemi zgjidhur një pjesë të
17 çështjeve që janë akoma të pazgjidhura.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Sytema.

20 Z. SYTEMA: [Përkthim] Qëndrimi i Mbrojtjes së z. Bahtjari
21 është i njëjtë. Nesër presim nxjerrjen e materialeve, hapat e
22 ardhshëm hetimorë dhe që mund të kenë ndikim bashkimin e
23 lëndës 11. Pra ka shumë pasiguri lidhur me mënyrën sesi do të
24 ecë përpara kjo çështje.

25 Mendimi im është që me kalimin e javëve dhe muajve kjo

1 çështje bëhet gjithnjë e më voluminoze. Nuk e dimë se cili do
2 të jetë impakti i bashkimit të çështjeve lidhur me këtë në
3 qoftë se një gjë e tillë vendoset. Gjithashtu, ka gjasa që
4 Mbrojtja në lëndën 11 të ketë dhe dëshirat e tyre, hapa për
5 t'u ndër marrë. Pra afati kohor që ne mendojmë nuk është
6 realist. Megjithatë, ne jemi në -- ne mbështesim një trajtim
7 të shpejtë të kësaj çështje.

8 Por, nuk besoj që është realiste ato data që janë dhënë
9 paraprakisht.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

11 Kalojmë tek pika e radhës në agjendë që ka të bëjë me
12 çështjen e ngritur nga Mbrojtja e z. Januzi që ka të bëjë me
13 çështjet e materialeve informatike në dispozicion të z. Januzi
14 për përgatitjen e lëndës së tij.

15 Fillimisht do të diskutojmë çështjet e ngritura nga
16 Mbrojtja e z. Januzi në paragrafin 17(a) dhe 17(c) të
17 parashtrimeve me shkrim; konkretisht, çështja e regjistrimit
18 në platformën Zoom dhe pajisjet kompjuterike. Do të kalojmë në
19 seancë private për të diskutuar pikën e ngritur në paragrafin
20 17(b) të parashtrimeve të Mbrojtjes.

21 Z. Rees, do t'ju jap fjalën tani që të diskutojmë pikën
22 17(a) dhe 17(c), ju lutem.

23 Z. REES: [Përkthim] Po, faleminderit. Të dyja janë të
24 qarta dhe -- rregullat parashohin se të ndalurit në qendrën e
25 ndalimit do të kenë qasje në pajisje të duhura për të

1 përgatitjen e -- për të përgatitur mbrojtjen e tyre. Ka
2 udhëzime konkrete, të qarta që e bëjnë të qartë që kjo
3 përfshin edhe qasjen në pajisje kompjuterike, një kompjuter që
4 mund ta përdorin. Dhe kjo është një procedurë që është krijuar
5 në Çështjen 07, në fakt, kjo i jepte mundësi çdo të ndaluar
6 që të kenë qasje në një kompjuter dhe të kenë qasje në dosjet
7 e tyre për të mundësuar transmetimin elektronik mes avokatit
8 dhe të paraburgosurit pra. Edhe ky sistem quhet SEDS, që është
9 shkurtesa me të cilën është emëruar.

10 Në rastin e z. Januzi ai ka plotësuar kërkesat apo
11 formularët që duhen dhe duhet t'i jepet dhe nuk i është dhënë
12 akoma qasje në pajisje kompjuterike, që duhet t'ia mundësonin
13 atij të përdorë këtë sistem.

14 Çështja në pikën 17(a), ju i konstatoni vështirësitë me
15 të cilët me të cilët përballemi ne, dhe vështirësitë që po
16 shkaktojnë. Kemi përdorur shërbimin e lirë falas pra, që jepet
17 nga platforma Zoom dhe që na mundëson konsultim ligjor të
18 pandërprerë besoj për maksimum 40 minuta, përpara që të --
19 pastaj që sistemi të ndërpritet në mënyrë automatike dhe duhet
20 pastaj që të rilidhemi për të -- përmes linkut, pra,

21 E di, z. Gjykatës, që jemi të gjithë të vetëdijsëm për
22 këtë funksionim.

23 Njësia e paraburgimit kishin paguar më herët abonimin në
24 platformën Zoom, e cila shmangte këto ndërprerje dhe sistemi
25 punonte, funksiononte shumë mirë. Për arsye që nuk e di, ky

1 abonim ka përfunduar dhe nuk është ripërtërirë, nuk është bërë
2 përsëri, pra. Nuk e di pse ka ndodhur kjo. Është çështje e
3 rëndësishme sepse kur ne planifikojmë konsultime që zgjasim më
4 shumë se ajo periudhë kohore, pra 40 minuta, dhe pastaj
5 humbasim kohë duke u lidhur përsëri.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Së pari dua t'i jap fjalën
7 Zyrës Administrative, pastaj do t'ju jap fjalën për t'u
8 shprehur lidhur me paragrafin 17(b).

9 Dua t'ju jap fjalën z. Nilsson. Por, përpara sesa të
10 përgjigjeni pyetjes dua që t'ju pyes në qoftë se çështja që
11 ngrihet në paragrafin 17(a) është specifike lidhur me
12 Mbrojtjen apo është diçka e cila përdoret ose zbatohet për
13 gjithë këtë institucion.

14 Si fillim z. Nilsson fjala për ju.

15 Z. NILSSON: [Përkthim] Sikurse u theksua, ka rreth dy
16 javë që kemi disa vështirësi administrative që kanë të bëjnë
17 me abonimin në Zoom. Kjo ka penguar jo që të bëhen takimet
18 fare, por që të bëhen takime më të gjata sesa 40 minuta, sepse
19 takimet bëhen për 40 minuta pastaj bëhet një shkëputet dhe
20 duhet që të lidhen përsëri në sistem.

21 Mbrojtja e ngriti këtë çështje një njësinë e paraburgimit
22 dhe me stafin e Zyrës Administrative. Kështu që nuk do të ketë
23 probleme, do të zgjidhet në të afërmen e afërt.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju po thoni z. Nilsson që
25 problemi do të zgjidhet për Mbrojtjen, por jo për të gjithë të

1 tjerët në këtë institucion, apo jo?

2 Z. NILSSON: [Përkthim] Për sa i takon seancave gjyqësore
3 kjo është një çështje e zgjidhur. Ndërkohë që sa i takon juve,
4 të nderuar Gjykatës, ne për sa i takon Zoom-it ose elementëve
5 të IT-së për ju, po punojmë për të gjetur një zgjidhje të
6 qëndrueshme.

7 Nëse më lejoni, lidhur me pikën e dytë. Z. Januzi ka një
8 kompjuter, i është dhënë një kompjuter e ka në qelinë e vet
9 këtë kompjuter që të mund ta përdorë. Sa i takon sistemit SEDS
10 që u përmend nga Mbrojtja, përsëri dhe në mëngjes avokati e
11 ngriti këtë çështje me stafin e paraburgimit dhe kishte një
12 problem teknik. Është hera e parë që kemi dëgjuar për këtë
13 problem, në fakt.

14 Dhe pasi e kemi dëgjuar ankesën e Mbrojtjes janë marrë
15 disa masa nga stafi administrativ, kështu që besoj që duke
16 filluar nga sot, sistemi SEDS duhet të vazhdojë që të punojë
17 normalisht, të funksionojë normalisht përsëri.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.
19 Me çfarë shohim problemet ose po zgjidhen ose do të zgjidhen
20 është shpejti.

21 Z. Rees, a doni të thoni diçka?

22 Z. REES: [Përkthim] Jo, jam mirënjohës. Shpresoj që
23 problemet që keni ju me Zoom-in të mund të zgjidhen sa më
24 shpejt të jetë e mundur.

25 A mund të shtjelloj çështje që ka të bëjë me paragrafin

1 tjetër që kërkon hyrjen tonë në seancë private?

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në
3 seancë private, z. Sekretar.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jemi
10 në seancë të hapur.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar i
12 seancës.

13 Tani dëshiroj t'ju kërkoj palëve dhe Zyrës Administrative
14 të thonë nëse kanë pika të tjera që dëshirojnë të ngrenë.

15 Duke filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Znj. Prokurore, fjala për ju.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi asgjë tjetër për të
18 shtuar nga ana e Prokurorisë, faleminderit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, ju?

20 Z. REES: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Thjeshtë dua
21 që t'i them z. Nilsson që do i kërkoj ndihmë për të na ofruar
22 mbështetje përmes specialistit të IT-së për sa i takon *hard*
23 *drive*.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Nilsson është përgatitur
25 për këtë.

1 Z. Sytema.

2 Z. SYTEMA: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Nilsson, keni ndonjë gjë
4 për të shtuar?

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Nuk kemi asgjë tjetër nga Zyra
6 Administrative thjeshtë për të thënë që jemi të përgatitur për
7 të ofruar ndihmë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të jap urdhrin e
9 parë me gojë.

10 Pasi dëgjova palëve, e gjej me vend që të urdhëroj ZPS-në
11 që të dorëzojë aktakuzën e përbashkët për Çështjen 10 dhe 11
12 dhe përmbledhjen sipas rregullës 86(3) që ka të bëjë me
13 Çështjen 10 dhe 11.

14 Për më tej, e gjej me vlerë që t'u ndryshoj afatet e
15 parashikuara nga rregulloret për t'ju përgjigjur kërkesës së
16 përbashkët të ZPS-së që është parashtrimi i protokolluar
17 F000132.

18 Urdhëroj, së pari, që ZPS-ja të dorëzojë një aktakuzë të
19 propozuar të përbashkët dhe një përmbledhje sipas rregullës
20 86(3) përfshirë këtu edhe materialin sipas rregullës 86(3) për
21 Çështjet 10 dhe 11, jo më vonë se data 12 janar 2024 në orën 4
22 pasdite.

23 Së dyti, Mbrojtja e z. Januzi dhe Mbrojtja e z. Bahtjari
24 urdhërohen që t'i përgjigjen kërkesës së përbashkët të ZPS-së
25 që është parashtrimi i protokolluar F000132, jo më vonë se me

1 datë 19 janar 2024 në orën 4 pasdite.

2 Dhe, e treti, urdhëroj ZPS-në që të kundërpërgjigjet jo
3 më vonë sesa data 26 janar 2024 në orën 4 pasdite.

4 Këto përfundojnë urdhrin tim të parë me gojë.

5 Po ashtu dëshiroj që të informoj palët dhe Zyrën
6 Administrative se synoj që të organizoj Konferencën e radhës
7 për Ecurinë e Çështjes gjatë javës së 5 shkurtit 2024.

8 Në këtë aspekt kujtoj se nëse të akuzuarit dhe Mbrojtjet
9 dëshirojnë që të marrin pjesë përmes videolidhjes është e
10 nevojshme që të dorëzohen njoftimet me shkrim përmes postës
11 elektrike në Zyrën Administrative 24 përpara organizimit të
12 seancës përkatëse, në mënyrë që të bëhen rregullimet dhe
13 organizimet e nevojshme. Ky njoftim duhet të përfshijë
14 gjithashtu edhe pëlqimin me shkrim të të akuzuarit përpara
15 sesa të dorëzohet.

16 Ju do të merrni një urdhër për planifikimin e seancë me
17 rendin e ditës përpara konferencës së radhës. Dua që t'i ftoj
18 palët që të marrin fjalën në qoftë se dëshirojnë të ngrenë
19 ndonjë çështje specifike, përmes parashtrimeve me shkrim për
20 sa i takon konferencës së radhës.

21 Ky është fundi i seancës së sotme. Falënderoj palët,
22 Zyrën Administrative për praninë e tyre. Dhe dëshiroj të
23 falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët audio-vizual,
24 personelin e sigurisë, për ndihmën e tyre.

25 Seanca përfundon këtu.

1 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes mbyllet

2 në orën 12.47

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25